

KËRKESË
Nr. 2565, datë 25.4.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rivitalizim i pjesshëm pranë rrugës pedonale ‘Abaz Bej Lushnja’ Lushnjë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr.89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale shpronësimit është 320,397 (treqind e njëzetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

Vlera e shpronësimit e truallit të z. Shaban Daut Beqiri
 Në lagjen "Kongresi" Zona kadastrale 8571

INVESTITORI: BASHKIA LUSHNJË

Nr	N/ pasuris	Emri Mbiemri	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVHPP-ja
1	18/19	Shaban Daut Beqiri	8571	Truall	m2	33	9709	320397	Shkresa Nr.1921/1 date 20.03.2017
						Shuma totale		320397	